



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 2, Datë 22.07.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR “NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE
“BACKA 1”, “BACKA 2”, “BACKA A”, “BACKA B”, “BACKA C”, NË LUMIN E
STRATAVECKËS, BASHKIA SKRAPAR

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, nenit 19 të Vendimit nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, Vendimit nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për “Ndërtimin e Hidrocentraleve “Backa 1”, “Backa 2”, “Backa A”, “Backa B”, “Backa C”, me vendndodhje në lumin e Strataveckës, Bashkia Skrapar, me subjekt kërkues shoqërinë konçensionare “Kroi Mbret Energji” sh.p.k.
2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
 - a. Dokumenti i Rregullores së Lejes së Ndërtimit;
 - b. Harta e Planvendosjes së Strukturave të Hidrocentraleve.
3. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
4. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
5. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Njësia e Qeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMENTI


MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN

DAMIAN GJIKNURI


MINISTËR I ENERGJISË DHE INDUSTRIE

SEKRETARE E KKT

ADELINA GRECA



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

